



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:205644

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05529145

KF.nr.267/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Kosmonte Foods” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.B. avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi nr.225/2021 i datës 11.08.2021 i ATK-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të avokatit E.B. dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Kosmonte Foods” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson avokat E.B. , si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.225/2021, i datës 11.08.2021, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania “Kosmonte Foods” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 15.09.2021, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër vendimit nr.225/2021 i datës 11.08.2021 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor dhe në fjalën përfundimtare pala paditëse ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë kërkesëpadisë të parashtruar nga ana e Kompanisë “Kosmonte Food” lidhur me vendimin e ATK i cili obligon Kompaninë “Kosmonte Food” të paguajë një gjobë prej 1,200.00 € si pasojë e mos prezantimit të fletëngarkesës nga ana e punonjësit E.M. agjent tregtar

në kompaninë “Kosmonte Foods”. Ka theksuar se lidhur me këtë çështje e ka njoftuar gjykatën se Kompania “Kosmonte Foods” Sh.P.K., ka prezantuar të gjitha faktet dhe provat me të cilat dëshmon se në rastin kur është ndalur punonjësi nga ana e Policisë së Kosovës ka prezantuar fletëngarkesën nëpërmjet telefonit të tij, mirëpo i njëjti origjinalin e fletëngarkesës e ka harruar në depon e kompanisë aty ku është ngarkuar andaj ka theksuar se ka të bëjë me një çështje teknike dhe jo me mungesë të fletëngarkesës e cila mund të arsyetohet si mall pa origjinë se kjo çështje nuk qëndron pasi që Kompania “Kosmonte Foods”, ka prezantuar pranë ATK-së në Istog faturën e rregullt të mallit të porositur te prodhuesi i produkteve “Perutnina Food”, së bashku me DUD-at të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj padie. Përveç kësaj ka shtuar se agjenti tregtar ka prezantuar të gjitha faturat e shitjes tek të gjithë klientët e “Kosmonte Foods”, për produktet me të cilat ishte i ngarkuar në automjetin e tij. Ka theksuar se faturat përputhen me sistemin GPS ku vërtetohet se automjeti në fjalë ka shitur mallin tek të gjitha pikat ku ka lëshuar fatura të rregullta. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj kërkesëpadinë e Kompanisë “Kosmonte Foods” duke e obliguar ATK-në të bëjë kthimin e mjeteve të precizuara në padi me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës për parashtrim të padisë në shumë prej 104.00 € si dhe për përfaqësim në gjykatë në shumë prej 135.20 €.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 28.10.2021, e konteston padinë e paditësit duke theksuar se lëshimi i ndëshkimit për mallrat pa origjinë, është vërtetim i gjendjes faktike në momentin e caktuar kohor, ka shtuar se konstatimi i mallrave pa origjinë justifikohet me vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vizitës operative të Inspektorit Tatimor me datë 07.05.2021, ku kanë konstatuar se paditësi/tatimpaguesi gjatë ndaljes së kamionit nga Polica e Kosovës ka poseduar mallra pa origjinë në vlerë 597.99 € dhe mallrat në posedim nuk i ka dokumentuar me as një dokument (si DUD-ë, faturë, kuponë apo pagesë) siç parasheh neni 13 paragrafi 5 i Ligjit nr.03/L-222 dhe neni 19 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. E paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.03.2024, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ka pranuar ftesën për këtë seancë, nuk ka prezantuar duke e njoftuar Gjykatën me parashtrësën e datës 19.03.2024, se nuk do prezantohet në seancë dhe njëherit ka kërkuar nga Gjykata të veproj në pajtim me nenin 38, par 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ, andaj Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, e ka proceduar çështjen duke i lexuar parashtrësat e të paditurës. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi nr.225/2021 i datës 11.08.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 26.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Ankesën në DA datës 16.06.2021, Fletëngarkesë nr. 1-4/50902, Vërtetim i datës 02.05.2021, Dokumenti 01.05.2021, Fletëngarkesë 01.05.2021, Flete dërgesë 803410905, 803410817, 803410818, 80341031, ASYCUDA printuar me datë 01.05.2021, DUD 2021 479, CMR 2007802, DUD R 6977, Pagesë e faturës datës 01.05.2021 bashkë me urdhërpagesë, Certificate AUV datës 29.04.2021, Faturat e bashkangjitura padisë, Dëshmia e sistemit GPS, Përgjigja në padi, Raporti fillestar i incidentit, Deklaratë e të dyshuarit, Raporti i oficerit, Vërtetim i datës 02.05.2021, Foto dokumentacion, Letërnjoftim i E.M., Autorizimi i datës 04.02.2021, Forma për vizitë përmbushëse e datës 07.05.2021, Vendim i ZGJONA i datës 20.05.2021, Njoftim vlerësimi, Vendimi kontestues 225/2021 i datës 11.08.2021 dhe Kontratë pune provuese e datës 19.01.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave i ATK-së, e ka refuzuar ankesën e subjektit në procedurë, duke konstatuar se tatimpaguesi është ndëshkuar në mbështetje të nenit 53 par.2.4 në vlerë prej 1,000.00 €, për shkak të mos mbajtjes së librave dhe regjistrimeve dhe 149.50 € sipas nenit 59 për shkak të konstatimit të mallit pa origjinë të Ligjit nr.03/L-222, gjithsej në vlerë prej 1,149.50 €. Sipas vlerësimit të Divizionit të Ankesave, lëshimi i ndëshkimit për mallrat pa origjinë, është vërtetim i gjendjes faktike në momentin e caktuar kohor. Konstatimi i mallrave pa origjinë justifikohet me vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vizitës operative të Inspektorit Tatimore me datë 07.05.2021, ku ka konstatuar se tatimpaguesi gjatë ndaljes së kamionëve nga Policia e Kosovës (dhe shkresave të ofruara) ka poseduar mallra pa origjinë në vlerë prej 597.99 € dhe mallrat në posedim nuk i ka dokumentuar me as një dokument si: DUD-ë, faturë, kuponë apo pagesë siç parashihet në nenin 13 paragrafi 5 i Ligjit nr.03L-222 dhe neni 19 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. Nga kjo nënkuptohet se një tatimpagues duhet të jetë në gjendje të ofroj dokumentacionin mbështetës i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së

tatimpaguesit. Gjithashtu tatimpaguesit duhet të jetë në gjendje të dokumentoj të gjitha mallrat nga koha e pranimit qoftë përmes importit, blerjes apo shkëmbimit apo mënyrë tjetër deri sa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër. Andaj me këtë vërtetohet se paditësi si tatimpagues ka bërë shkelje tatimore i cili sanksionohet sipas nenit 59 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku kjo dispozitë parasheh *“Kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomike posedon mallra pa origjinë, ai person do të i nënshtrohet ndëshkimit administrativë me njëzetepesë përqind (25%) të vlerë së tregut të mallrave”*

Ndërsa sa i përket pretendimit të paditësit se punonjësi i Kompanisë “Kosmonte Foods” Sh.P.K., z.E.M., ka qenë punonjës fillestar në kompaninë në fjalë dhe i njëjti në ditë kur është ndal nga ana e Policisë së Kosovës nuk e ka poseduar me vete fletëngarkesën e mallit, por ai përmes fotografisë në telefon e ka prezantuar, e vlerëson si të pa bazuar këtë pretendim për arsye se e paditura në vendimin nr.225/2021 të datës 11.08.2021 ka theksuar se vlerësimi nga tereni i Inspektorit është vërtetim i gjendjes faktike në momentin e caktuar kohor e që sipas dispozitave ligjore çdo tatimpagues mallrat në posedim në rastin konkret gjatë shitjeve ambulante duhet ti dokumentoj me prova materiale e këtë nuk e ka bërë.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Në vijim Gjykata, pretendimin e paditësit se vendimi i kontestuar është nxjerr në shkelje esenciale të dispozitave përkatëse procedural, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këto pretendime e që sipas nenit 7, Paragrafi 1 dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i*

*mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*". Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.267/22 datë 26.03.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.